

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

**OBJEKTI I PROCEDURËS: SHPENZIME PËR MIRËMBAJTJEN E OBJEKTEVE
SPECIFIKE**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
50312600-1 - Mirëmbajtje dhe riparim i pajisjeve të teknologjisë së informacionit**

VLERA E FONDIT LIMIT: 2.500.000 (dy milion e peseqind mijë) Lekë, pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(ndryshuar), autoriteti/enti kontraktor **Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; në vlerën _____ Lekë ().*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(ndryshuar)

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatori ekonomik duhet te paraqese kopje të Deklaratave të Xhiros Vjetore të lëshuar nga administrate tatimore për tre vitet e fundit 2019, 2020, 2021, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 39% e vlerës së fondit limit të kontratës që po prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2.2 Kopje të çertifikuara të bilanceve të vitit 2019, 2020, 2021 te leshuara nga administrata tatimore, të konfirmuara nga Administrata Tatimore, sipas *legjislacionit në fuqi*.

Ku te paketn ne dy bilance te njepasnjeshme , nuk ka raport negativ ndermjet aktivitet dhe pasivit

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qendrueshëm.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.2.3 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim/e për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga pushteti vendor për vitin 2022 sipas afateve të maturuara/përcaktuara dhe parashikuara në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, lëshuar prej njësisive të vetëqeverisjes vendore ku operatori ekonomik ushtron dhe ka ushtruar aktivitetin, sipas ekstraktit të QKB, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin/et e lëshuar nga njësia/të e vetëqeverisjes vendore përkatëse.

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore, do të

dorëzohët vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Enti /Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten te verifikojë vertetesine e informacionit te paraqitur ne procedure e prokurimit.Ne rast injformacioni te pasakte do te veprohet conform parashikimeve te ligjit Ligjit nr.162/2020 “Per Prokurimin Publik”

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të LPP dhe ne ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. Kjo vlerë shërben për ti garantuar AK se operatorët ekonomik kanë besueshmëri financiare .

Është një kriter që i jep AK një panoramë më të qartë mbi kapacitetin dhe korrektësinë e operatorëve ekonomik.

2.3 Kapaciteti teknik

2.3.1 Operatori Ekonomik ofertues duhet të vërtetojë që ka realizuar Shërbime të ngjashme, me vlerë jo më pak se 39 % e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjisllacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjisllacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4 B të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar, ku parashikohet se:

Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 39 % të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera për shërbime të ngjashme përbën një nivel të mjaftueshëm përvoja duke patur parasysh objektin dhe vlerën e kontratës.

$$39\% * 2.500.000L = 975.000 L$$

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdosshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

2.3.2 Operatori Ekonomik duhet të vërtetojë se disponon kualifikimet e duhura të stafit drejtues përkatës, për kryerjen e shërbimit në objekt. Për këtë, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacion që ka si të punësuar dhe të regjistruar në kompaninë e tij minimalisht 10 punonjës, vërtetuar me listëpagesat e 3 Muajve të fundit, nga të cilët.

- a) 1 (një) Inxhinier elektronik.
- b) 1 (një) Inxhinier Informatik/Specialist TIK
- c) 1 (një) Inxhinier Telekomunikacioni/Inxhinier Elektrik

Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin diplomat dhe listpagesat e 3-Muajve te fundit

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4 paragrafi b) i VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e tyre te nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit dhe/ose komponentët e tij. Konkretisht:

Të gjithë specialistët e kërkuar janë të nevojshem për realizimin e shërbimeve të kërkuara në specifikimet teknike të kësaj procedure. Në këtë shërbim kërkohen disa lloje inxhinierësh, pasi sistemi i kameras termale është specific dhe kërkon mbulim profesional në disa fusha.

Disponimi i stafit teknik të kërkuar krijon bindje tek Autoritetin Kontraktor se OE ofertues ka kapacitetet profesional për realizimin e kontratës.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në staf 1 (një) inxhinier të pajisur me çertifikatë Lead Auditor për "Sistemin e menaxhimit të Sigurisë së Informacionit"(ISO:27001:2013) e vërtetuar kjo me çertifikaten përkatëse dhe listpagesën e 3 muajve të fundit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41, pika 4 paragrafi b) i VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e tyre te nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit dhe/ose komponentët e tij. Kjo çertifikatë kërkohet pasi i jep garanci AK se përdorimi i sistemit do të bëhet vetëm për qëllimin e përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor.

2.3.4 Operatori Ekonomik duhet të ketë minimumi 3 (tre) punonjës të siguruar si montues të pajisjeve elektronike/ teknik elektronik, kjo e vërtetuar me listpagesat e 3-muajve të fundit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41, pika 4 paragrafi b) i VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e tyre te nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit dhe/ose komponentët e tij. Montuesit kërkohen pasi kamera termale është e pozicionuar në majën e një kulle 20 m të lartë dhe me një peshë mbi 50 kg.

2.3.5 Operatori Ekonomik duhet të ketë minimumi 2(dy) punonjës te certifikuar nga kompania prodhuese e sistemeve te kamerave, e vërtetuar me çertifikaten perkatëse dhe te figurojnë ne listëpagesen e 3- muajve te fundit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41, pika 4 paragrafi b) i VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e tyre te nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit dhe/ose komponentët e tij. Konkretisht Punonjësit e certifikuar

nga prodhuesi janë garanci për AK se operatori ekonomik ka aftësi profesionale të vërtetuara për pajisjet që do të ofroj shërbim mirëmbajtje dhe do jetë në gjendje të mbulojë cdo problematikë të tyre.

2.3.6 Operatori Ekonomik duhet të ketë minimumi 2(dy) punonjës të certifikuar nga kompania prodhuese e sistemeve të alarmeve, të vërtetuar me certifikatën përkatëse dhe të figurojnë në listëpagesën e 3- muajve të fundit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4 paragrafi b) i VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e tyre të nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit dhe/ose komponentët e tij. Konkretisht Punonjësit e certifikuar nga prodhuesi janë garanci për AK se operatori ekonomik ka aftësi profesionale të vërtetuara për pajisjet që do të ofroj shërbim mirëmbajtje dhe do jetë në gjendje të mbulojë cdo problematikë të tyre.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesi nga kompanitë prodhuese të kamerave dhe alarmeve një deklaratë/autorizim se do të ofroj suport për operatorin ekonomik gjatë gjithë periudhës së mirëmbajtjes .

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4 paragrafi c) i VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që gëzojnë autoritetin e duhur të deleguar nga prodhuesi për të shërbyer në pajisjet që do të mirëmbajnë. Kjo minimizon riskun për mos respektimin e kushteve të kërkuara mbi kohën dhe cilësinë e shërbimeve që do të ofrohen.

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të paraqesi certifikatat si më poshtë vijon:

- ISO 9001:2015 ose ekuivalente;
- ISO 14001:2015 ose ekuivalente
- ISO 27001:2013 ose ekuivalente

Certifikatat e mesiperme duhet te jenë të lëshuara nga organizmat e vleresimit te konformitetit, te cilat jane te akredituara nga Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga organizmat nderkombetare akredituese te njohura nga Republika e Shqiperise). Çertifikata të jetë e vlefshme dhe te kete lidhje me objektin e prokurimit. Ne rastin e Bashkimit te Operatoreve Ekonomik certifikatat duhet te paraqiten te pakten nga secili prej anetareve.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 dhe 79, të LPP ku parashikohet se:

Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

2.3.9 Operatori Ekonomik që do të realizojë instalimin, duhet të disponojë 2 (dy) automjete per te ofruar shërbimin e mirembajtjes brenda 24 orëve.

Të gjitha mjetet duhet të shoqërohen me Çertifikatë pronësie ose kontratë qeraje të noterizuar, Leje qarkullimi ,Siguracion i vlefshëm, , taksa te paguara dhe leje drejtimi.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4 paragrafi Ç) i VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e nevojshme për realizimin me sukses të objektit të prokurimit dhe/ose komponentët e tij.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar nga grupi i posaçëm i cili është ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike në përputhje me nenit 4, pika 38/b dhe nenit

36, të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.